



KORRUPSIONI NËN MONITORIM



RAPORTI 3 MUJOR I QËNDRËS FOL
PERIUDHA E MONITORIMIT
GUSHT - TETOR 2022





Tabela e Përmbajtjes

01

HYRJE

03

METODOLOGJIA

04

PËRMBLEDHJE

09

NGJARJET E
FUNDIT

10

GRAFIKË DHE
ANALIZA



Raporti i parë 3 muor në projektin

FOL PËR DREJTËSINË



Raporti i monitorimit 3 muor Gusht-Tetor 2022 është raporti i parë i një serie prej 4 raportesh që do të paraqiten nën projektin "FOL" për Drejtësinë - SPEAK for Justice, që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së, në Tiranë. Në këtë raport do të pasqyrohen të dhënat e analizuar nga baza e të dhënave "Databaza "Fol", e populluar me të dhëna të gjeneruara nga ekspertët në terren për kategorinë e çështjeve që janë paraqitur në gjykatë dhe që u monitoruan nga Qendra "FOL" në projektin e shkuar, me fokus të veçantë në aktivitetin e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ashtu sikurse dhe rastet e reja që regjistrohen çdo ditë. Raportet do të pasqyrojnë në intervale 3 mujore hulumtimin mbi statusin e procedimit dhe historinë gjyqësore të rasteve të kaluara por dhe rasteve të reja për ato vepra penale që vazhdojnë të jenë nën hetim dhe nuk janë mbyllur ende nga Prokuroria e Tiranës, lidhur me dyshimet për abuzim, por edhe aktet e korrupsionit dhe zgjedhjet që u monitoruan nga Qendra në SPAK. Raportimi ka si qëllim të pasqyrojë përmbledhje të strukturuar të mbikqyrjes që realizojnë ekspertët në terren të çështjeve të korrupsionit, shpërdorimit të detyrës dhe tenderave dhe çdo punë tjetër lidhur me zyrtarët e lartë, për të kuptuar se cilat janë problemet kryesore dhe ku hetimi nuk zhvillohet më tej në hallkat e përcaktuara në sistemin e drejtësisë

Të dhënat publike rrisin transparencën dhe ofrojnë mundësitë për analiza krahasimore e jo vetëm. Raportet e gjeneruara mbi elementë të ndryshëm të veprave penale nën juridiksionin e SPAK, por duke pasur në fokus subjektin e kryerjes së tyre informojnë publikun e gjerë rreth të dhënave kualitative dhe kuantitative, apo si institucionet publike reflektojnë në momentin e ndjekjes, hetimit dhe gjykimit të autorëve të dyshuar. Ekspertët e Qendrës "Fol" monitorojnë aktivisht procesin e procedimeve penale të regjistruara nga SPAK. Rastet popullojnë bazën e të dhënave "Databaza "Fol" e cila tashmë rezulton një arkivë digjitale e aksesueshme për të gjithë palët e interesuara. Monitorimi i rasteve përfshin fazat e hetimit, nga ato paraprake deri në Gjykatën e Lartë. Raportet mbartin një analizë kualitative dhe kuantitative mbi të dhënat që popullojnë "Databazën "Fol". Në raport do të gjenden përfaqësimet vizuale grafike në formate të ndryshme të të dhënave me analizën përkatëse.




KRIMI I ORGANIZUAR



KORRUPSIONI



DROGA



83

RASTE NË KËTË RAPORT

FOKUSI TEK SPAK

Puna e Prokurorisë Speciale Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar do të jetë nën monitorimin aktiv të ekspertëve të Qendrës "Fol" në Projektin "Fol për Drejtësinë" 2022-2023. Kategoritë e veprave të monitoruara janë grupuar nën 3 kategori: Korrupsionin, Krimin e Organizuar dhe Drogave

Raportimi është realizuar bazuar në kërkimin sasior dhe cilësor duke përfshirë një hetim sistematik me fokus në vlerat numerike të përftuara nga baza e të dhënave funksionale, “Databaza “FOL”. Procesi ka qenë iterativ, duke qenë se raporti 3-mujor është një raport progresiv, që përmbledh grumbullimin dhe strukturimin e gjetjeve të realizuara me bazë mujore. Analiza deskriptive ose përshkruese shoqëron vizualizimin e të dhënave në formë tabelore dhe grafike. Statistikat përshkruese tregojnë dhe përmbledhin tiparet themelore të një grupi të dhënash të gjetura në “Databazën “Fol”, të paraqitur në një përmbledhje që përshkruan mostrën e të dhënave dhe matjet e saj.



Fazat e realizimit të të dhënave

(1)mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave të realizuar nga gazetarët në bazën e të dhënave të quajtur “Databaza “FOL”;(2) menaxhimi i të dhënave që përfshin saktësimin, normalizimin e të dhënave dhe ndryshimet sipas rastit; (3) kontrollin e cilësisë së të dhënave; (4)analizën e thelluar mbi të dhënat; (5) vizualizimin e analizës dhe gjenerimin e raporteve sipas kërkesave të projektit

Burimi i të dhënave

Burimi i të dhënave gjenerohet nga investigimi dhe dosjet hetimore publike, vendimmarrjet e dhëna nga tre shkallët e gjyqimit, përkatësisht Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (Gjykatave dhe Prokurorive SPAK), si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit

Dispozitat legjislationit penal material në themel të veprimtarisë së ekspertëve janë:

Neni 244 ; Neni 244/a; Neni 245; Neni 245/1; Neni 258; Neni 259; Neni 259/a; Neni 260; Neni 312; Neni 319; /a; /b;/c ;/ç; /d; /e të Kodit Penal në Republikën e Shqipërisë. Përfshihen dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë ,deputetit , zëvendës ministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj; Akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës. Krahas tyre janë dhe Nenet 135, 283,284,333/a,334 të K.P.

Përmbledhje e gjurmimit të rasteve të trajtuara më parë për korrupsionin

1

Raportimi realizuar mbi të dhëna të grumbulluara rishtazi ose të përditësuara

në “Databazën “Fol” nga ekspertët në periudhën Gusht 2022 – 31 Tetor 2022. Këto të dhëna i korrespondojnë rasteve të trajtuara nga muaji Nëntor 2020 deri në Tetor 2022. Gjatë kësaj periudhe ekspertët e Qendrës “Fol” kanë shqyrtuar **83** raste prej të cilave **69** raste kanë të bëjnë me procedime për veprat penale që kategorizohen në fushën e Korrupsionit, 5 raste për vepra penale të kategorizuara në Krimin e Organizuar dhe **9** raste për vepra të kategorizuara në fushën e Drogave. Rastet lidhur me korrupsionin përbëjnë 82% të rasteve në total të trajtuara në këtë periudhë raportimi. Ekspertët e Qendrës “Fol” kanë monitoruar gjendjen në shkallët e gjykimit apo statusin e hetimit për **59** raste të projektit 2020-2021[1], ku 29 raste ose **49%** janë nën kompetencën e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Në këto 23 raste SPAK, krahas kërkesës për gjykim, ka kërkuar caktimin e masës së sigurisë “arrest në burg” për **16** shtetas, masën e sigurimit personal “arrest në shtëpi” për 4 shtetas dhe vetëm në 1 rast ka kërkuar masën e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Organi i akuzës ka vendosur mos fillimin e procedimit penal në **2** raste, ndërsa ka shpallur moskompetencën në 4 raste të tjera.

2

Shpërdorimi i detyrës si vepra penale më e konsumuar nga të tjerat

Janë 27 shtetas ose rreth 46% e numrit total të shtetasve nga rastet e përditësuara nga projekti 2020-2021 që rezultojnë të jenë referuar për procedim penal për konsumimin e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i K.P. Nga këta shtetas në 2 raste SPAK ka depozituar kërkesën për gjykim dhe ka kërkuar caktimin e masës së sigurisë personale “arrest në burg”. Ekspertët kanë gjurmuar aktivitetin në shkallën e gjykimit për këta shtetas, nga masa e sigurisë së kërkuar nga organi i akuzës e deri në shkallën e dytë të gjykimit. Rastet i korrespondojnë hetimit të realizuar nga SPAK në Bashkinë Lushnje për shpalljen fitues të tenderit për rehabilitimin e një ujësjellësi, një subjekt që nuk plotësonte kriteret ligjore. Me kërkesë të Prokurorisë, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr.50 datë 05.07.2021 ka caktuar masat e sigurimit arrest në burg për Kryetarin e Bashkisë për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248-25 i Kodit Penal dhe Drejtorin e Pasurisë Publike në Bashkinë Lushnje për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” në bashkëpunim, “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tender apo ankande publike”, kryer në bashkëpunim, sipas neneve 248-25, 258-25 të Kodit Penal. Edhe në Gjykatën e Apelit pranë Gjykatës së Posaçme për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar (GJKKO) është lënë në fuqi masa e arrestit me burg për këta dy shtetas.

Përmbledhje e gjurmimit të rasteve të trajtuara më parë për korrupsionin

3

Krimi në drejtësi nga përfaqësues apo ish-përfaqësues të sistemit të drejtësisë

Janë një tjetër kategori rastesh të monitoruara nga ekspertët e Qendrës për të analizuar aktivitetin e hetimit dhe historinë gjyqësore të tyre. Rastet e trajtuara nën kategorinë e korrupsionit janë subjekte të veprave penale të trajtuara nga K.P., përkatësisht Neni 319-Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të lartë të drejtësisë; Neni 319/ç - Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të lartë të organeve të drejtësisë. Në periudhën e raportimit janë përfshirë për analizë 9 raste, të cilat përbëjnë 15% të rasteve të hulumtuara në këtë raport. Janë 4 shtetas të akuzuar për konsumimin e veprës penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319 dhe 25 të Kodit Penal. Në të katër rastet masat e sigurimit “arrest në burg” të kërkuara nga organi i akuzës janë lënë në fuqi nga të dyja shkallët e gjykimit. 3 prej këtyre rasteve janë të lidhura me operacionin e iniciuar nga SPAK në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, kurse një rast është i lidhur me përfshirjen e ish-drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë në Kukës. Për 3 rastet e Krujës Gjykata e Posaçme e Apelit la në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë ku shtetasit u dënuan me 2 vjet e 6 muaj, të konvertuar në 1 vit e 8 muaj për ulje dënimi për shkak të gjykimit të shkurtuar.

Gjykata e Posaçme e Apelit dënoi me 2 vite shtetasin I.G në çështjen lidhur me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Kukës, dënim i cili u ul në 1 vit për shkak të gjykimit të shkurtuar. Gjykimi për rastet ka rezultuar në dënim të ndryshim, për konsumimin e të njëjtës veprë penale. Janë 3 raste për të cilat shtetasit janë akuzuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të lartë të organeve të drejtësisë”. Në mesin e tyre janë ish-gjyqtare dhe prokurorë të hetuar nga SPAK, për të cilët është kërkuar masë sigurimi personal “arrest në burg”. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë i shpalli fajtor, duke kërkuar masën e sigurisë “arrest në burg”. Në monitorimin e rasteve nga ekspertët është konstatuar se në 2 raste Gjykata e Posaçme e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë sa i takon fajësisë dhe masës së dënimit, kurse në 1 prej tyre ktheu vendimin duke i hequr nenin 59 dhe kërkoi rikthimin në burg për të vuajtur dënimin. Në monitorimin e ekspertëve u evidentuan dhe 2 raste në të cilat ka bashkërendim të veprave penale, përkatësisht të nenit 245/1 dhe 319/ç dhe nenit 244 me 319/ç. Të dyja rastet janë të lidhura pasi i përkasin të njëjtit hetim të zhvilluar nga SPAK në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë. Për të dy shtetasit është kërkuar nga prokuroria masa e sigurisë “arrest në burg”, e lënë në fuqi në dy shkallët e gjykimit.

Përmbledhje e gjurmimit të rasteve të trajtuara më parë për korrupsionin

4

Korrupsioni aktiv në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021

ishte subjekt i monitorimit nga ekspertët e Qendrës “Fol”. Ekspertët patën analizuar rastet të cilat u përkasin veprave penale të parashikuara në nenet 328 dhe 328/a në Kodin Penal. Në raportet e SPAK, lidhur me materialet e regjistruara për krimet zgjedhore, rezultojnë të regjistruara 149 materiale. Nga këto materiale ekspertët e Qendrës “Fol” gjatë projektit 2020-2021 kanë shqyrtuar 25 raste, prej të cilave 2 janë ndjekur më në detaj në projektin e ri 2022-2023 dhe për të cilat është përditësuar vendimi i gjykimit në 2 shkallë. Të 2 shtetasit janë arrestuar në flagrancë nga Specialistët për Hetimin e Krimit në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër për veprat penale "Korrupsioni aktiv në zgjedhje" kryer në bashkëpunim dhe "Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore". SPAK përfundoi hetimet paraprake për procedimin penal nr.136 viti 2021, ku shtetasit janë hetuar me masën e sigurimit personal “arrest në burg”. Pas provave të marra, SPAK ka referuar në Gjykatën e Posaçme për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të të pandehurve.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe më pas Gjykata e Posaçme e Apelit kanë dhënë të njëjtin verdikt, duke lënë në burg shtetasit, të cilët kanë konsumuar veprën penale “Korrupsion aktiv në zgjedhje”. Këto dy raste, në fakt, janë ndër të paktat raste ku janë dhënë dënime konkrete nga Gjykatat për veprat penale të krimit zgjedhor. Në artikullin “Moskompetenca, instrumenti që “shpëtoi” hetimet për korrupsionin në zgjedhje”[1] ekspertët e Qendrës kanë hulumtuar mbi moskompetencën e shpallur nga Prokuroritë e Rretheve e më pas të SPAK për hetimet në zgjedhje. Edhe në vetë raportimet e SPAK, në 45 çështjet që mbajti për hetime të mëtejshme në 18 raste shpalli moskompetencën duke i deleguar në Prokuroritë e rretheve. Ekspertët e Qendrës “Fol” po punojnë për përditësimin e statusit gjyqësor dhe nivelit të hetimit për rastet e trajtuara që kanë lidhje me Krimin Zgjedhor. Në raportin 6 mujor do të pasqyrohen rezultatet e këtij shqyrtimi.

Përmbledhje e gjurmimit të rasteve të trajtuara më parë për korrupsionin

5 Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike, ose i funksionarëve të lartë shtetërorë apo të zgjedhurve vendorë dhe ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj tyre

është kategoria tjetër e veprave penale që është monitoruar nga ekspertët ndër 59 rastet e përditësuar në status dhe gjendje gjyqësore nga projekti i Qendrës “Fol” për vitin 2020-2021. Rezultojnë 16 raste për të cilat ekspertët kanë marrë informacion dhe kanë përditësuar gjendjen gjyqësore. Praktikisht janë 27% e rasteve të trajtuara. Të paktën 6 prej këtyre rasteve janë të lidhura me hetimin e SPAK, të realizuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë. Policia arrestoi me urdhër të SPAK 10 persona, nëntë për korrupsion dhe një për ekspertim të rremë. 4 prej shtetasve të arrestuar nga Policia, pas hetimeve të SPAK, janë arrestuar për konsumimin e veprave penale Neni 245/1 -Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike; Neni 319/ç - Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të lartë të organeve të drejtësisë, Neni 244 - Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike; Neni 319/ç - Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të lartë të organeve të drejtësisë, Neni 245/1 - Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike. SPAK ka kërkuar që të pajisen me masën e sigurisë “arrest në burg”, masë e dhënë dhe nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Posaçme e Apelit.

Gjatë përgjimeve në këtë dosje hetimore SPAK dyshon se mjeku E.P ka bërë korrupsion me sekretaren e Gjykatës së Krujës, e cila e pagoi 2 mijë euro për një operacion për të ëmën. 2 Infermiere u arrestuan për ushtrim të ndikimit të paligjshëm të funksionarëve publik. Në këto dy raste SPAK nuk ka kërkuar masa shtrënguese. Në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë është kërkuar në 1 rast pezullim i ushtrimit të detyrës dhe në një rast tjetër paraqitje në policinë gjyqësore. Gjykata e Posaçme e Apelit ka vendosur që për të dy rastet të kërkohet masa “pezullim i ushtrimit të detyrës” dhe i ka dënuar përkatësisht me 1 vit dhe tjetrin me 8 muaj shërbim prove. Në 8 raste të tjera shtetasit kanë konsumuar veprën penale Neni 245/1 – “Ushtrim i ndikimit të paligjshëm 1.ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”. Në këto 8 raste shpërndarja përsa i përket masës së sigurisë së kërkuar nga prokuroria është:

- 4 raste është kërkuar masa e sigurisë “arrest në burg” e cila është lënë në fuqi në 3 raste nga Gjykata e Posaçme e Apelit dhe ku, një rast nga arrest në burg ka kaluar në shërbim prove.
- 4 raste është kërkuar masa e sigurisë “arrest në shtëpi”, masë e lënë njësoj nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, por e ndryshuar në 3 raste nga Gjykata e Posaçme e Apelit. Për 3 shtetase që janë hetuar në “arrest në shtëpi” Gjykata e Posaçme e Apelit ka kërkuar masën “arrest në burg”. Në 1 rast tjetër Gjykata e Posaçme ka ndërruar masën e sigurisë në shërbim prove.

Përmbledhje e gjurmimit të rasteve të trajtuara më parë për korrupsionin

Në 2 rastet e fundit shtetasit kanë konsumuar veprën penale Neni 244 – “Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”. Janë dy raste të lidhura me tentativën për të korrumpuar punonjësit e Policisë, në një rast për të shmangur testin e alkolit dhe në një tjetër për të shmangur bllokimin e automjetit, për shkak të mungesës së dokumentacionit.

6

Shkelja e barazisë në tender

është një tjetër kategori e veprave penale në fushën e korrupsionit, që është monitoruar nga ekspertët e Qendrës “Fol”. Në rastet e shqyrtuara për këtë raport të parë 3 mujor janë 2 raste të cilat SPAK i ka dërguar pranë Prokurorisë së Tiranës për mungesë kompetence kurse në rastin tjetër, një ngjarje e bujshme lidhur me tenderin për “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së shtetit ” për 4 vjet , me fond limit 2.800.347 .570 (dy miliard e tetëqind milion e treqind e dyzet e shtate mije e pesëqind e shtatëdhjetë leke) pa TVSH, ka kërkuar masën e sigurisë “arrest në burg për 8 shtetas dhe masën e sigurisë “arrest në shtëpi” për një shtetas tjetër, të gjithë konsumues të veprës penale “Shkelja e barazisë se pjesëmarrësve në tender apo ankande publike ”, në bashkëpunim , parashikuar nga Neni 258 - Shkelje të barazisë së pjesëmarrësve në tender apo ankande publike, 25 i Kodit Penal”; Në të dyja shkallët e gjykimit, qoftë Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë si dhe Gjykata e Posaçme e Apelit kanë lënë në fuqi të njëjtën masë sigurie.

Gjykata e Lartë rikthen për gjykim çështjen pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit me trupë tjetër gjykuese. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në datën 21.09.2022 shpalli vendimin lidhur me çështjen nr. 37, datë 30.03.2022 regjistrimi, me objekt “ankim ndaj vendimit nr. 93, datë 30.12.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, në ngarkim të të pandehurve E.N., F.Ç., A.B., A.O., A.M., K.H., K.B., F.D., M.B., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tender apo ankande publike” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 258 dhe 25 të K.Penal duke vendosur për lënien në fuqi të vendimit nr. 93, datë 30.12.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me ndryshimin vetëm sa i përket kohës së provës në këtë mënyrë: Të pandehurit A.B., A.O., G.M., vihen në provë për një periudhë kohe të barabartë me dyfishin e pjesës së mbetur pavuajtur të dënimit me burgim.

Duhet theksuar se në rastin e mësipërm SPAK është angazhuar pro aktivisht në realizimin e hetimit dhe është një nga çështjet që ka prodhuar dënimin e funksionarëve të lartë shtetëror të lidhur me procedura prokurimi publike, në të cilat abuzimet shkaktojnë dëme financiare, duke anashkaluar detyrën që duhet të jetë në dobi të interesit publik

10 raste

Të monitoruara për korrupsionin



30%

Ministri, Sistemi i Drejtësisë dhe Institucione publike



Neni 245

Korrupsion aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë



Kategoria e korrupsionit


Ekspertët e Qendrës "Fol" kanë monitoruar praktikat hetimore dhe gjyqësore që i korrespondojnë rasteve në kategorinë e korrupsionit për muajt Gusht – Tetor 2022. Janë 10 raste të cilat janë monitoruar në këtë kategori.

Të gjitha kallëzimet drejt SPAK


Në të gjitha rastet shtetasit i janë drejtuar Prokurorisë së Posaçme dhe kanë depozituar kallëzime penale për vepra penale të cilat gjerësisht përqendrohen në:



Neni 244 – Korrupsionin aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike", Neni 244/a – Korrupsion aktiv i nëpunësve të huaj publikë; Neni 245 – Korrupsion aktiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose të zgjedhurve vendorë ;Neni 248 – Shpërdorim detyre ; Neni 245 – Korrupsion aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë ; apo Neni 248 – shpërdorim detyre. Në vetëm një rast është caktuar mos fillim. Të akuzuarit janë më së shumti nga grup-kategoria Ministri dhe Drejtori përgjegjëse, sistemi i Drejtësisë apo persona që kanë mbajtur pozicione në institucione publike.



Korrupsioni sipas nenit



Rastet sipas kategorive




KRIMI I ORGANIZUAR DHE SPAK



Duke qenë se aktiviteti i SPAK është një nga elementët që do të shqyrtohet dhe monitorohet në vazhdimësi nga ekspertët e Qendrës “Fol” janë monitoruar disa raste nga projekti i kaluar 2020-2021, për të parë ecurinë e hetimeve apo gjendjen gjyqësore të shtetasve që kanë qenë subjekt i hetimeve. Ekspertët kanë monitoruar 5 raste të kategorizuar si krim i organizuar. Këto raste janë regjistruar nën veprat penale të “grupit të strukturuar kriminal” parashikuar nga neni 333/a K.P. dhe “kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal” normuar nëpërmjet nenit 334 K.P. Këto raste i përkasin emrave të rëndësishëm në botën e krimit, të cilët kanë qenë nën hetimin e SPAK.5 prej këtyre rasteve i përkasin të njëjtit procedim penal. Masa e sigurimit për të gjitha rastet e kërkuar nga ana e Prokurorisë rezultojnë “arrest në burg”, kërkesë e cila është aprovuar nga ana e Gjykatës së Posaçme në të gjitha rastet.

Masat sipas shkalleve të gjykimit




DISA TË DHËNA NGA HULUMTIMI MBI RASTET E TRAJTUARA NË RAPORTIN E PARË 3-MUJOR

Në 59 rastet e projektit të kaluar që u analizuan në këtë raport 3 mujor evidentohen rastet për të cilat janë konsumuar 2 shkallë të gjykimit. Nga 25 raste të tilla rezulton se në 18 raste Prokuroria, si Organ i Akuzës, ka kërkuar masën personale “arrest në burg”, e cila është lënë e tillë në 2 shkallët e gjykimit në një masë përputhshmërie 100%. Në 4 raste ku Prokuroria ka kërkuar “arrest në shtëpi”, Gjykata e Shkallës së Parë ka kërkuar në masën 100% po të njëjtën masë sigurie, ndërkohë që Gjykata e Apelit ka ri konfirmuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë në 3 raste kurse në një tjetër ka ndryshuar masën e sigurisë në “arrest në burg”. Pa përputhshmëria më e madhe me masën e sigurisë të kërkuar nga Prokuroria shfaqet në gjykimin e një rasti ku Prokuroria kërkon si masë sigurimi “paraqitje në policinë gjyqësore” ndërkohë që Gjykata e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit kanë vendosur për pezullim të ushtrimit të detyrës. Ndërkohë në 2 raste të tjera Prokuroria kërkon pezullim të ushtrimit të detyrës dhe Gjykata e Shkallës së Parë merr vendim për caktimin e masës së sigurisë “arrest në burg”, që kundërshtohet nga Apeli dhe vendoset për “pezullim të ushtrimit të detyrës”. Rasti tjetër ku Prokuroria kërkon “pezullim të ushtrimit të detyrës” është pranuar nga të dyja shkallët e gjykimit dhe shfaq një përputhshmëri në masën 100%.


Përzgjedhja e rasteve për tu shqyrtuar nga Projekti Fol për Drejtësinë 2020-2021

Ekspertët e Qendrës “Fol” kanë shqyrtuar raste të korrupsionit të projektit 2020-2021 për të evidentuar kursin e hetimeve dhe shkallën e gjyimit për to. Duhet thënë se përzgjedhja e rasteve të trajtuara ka qenë rastësore, sikurse tregon dhe shpërndarja në grafik. Shpërndarja e 59 rasteve të kategorisë së korrupsionit në muaj të vitit ka kulmuar me 21 raste të shqyrtuara që kanë ndodhur në Shkurt të vitit 2021.

Rastet e shqyrtuara në raport, të shpërndara sipas datës së ngjarjes



● 9% Përqindja e rasteve të korrupsionit në këtë raport nga të gjitha rastet e korrupsionit 2020-2021





Korrupsioni në monitorim, Fol për
Drejtësinë Gusht - Tetor 2022

Në rastet e trajtuara në raportin e parë 3 muajor nga 59 raste të shqyrtuara nga ekspertët nga monitorimi i projektit 2020-2021 rezulton se Prokuroria ka paraqitur kërkesë për gjykim në 26 raste ose 44% të rasteve, dhe mos fillim në 5 të tjera. SPAK ka qenë organi i akuzës në 21 prej 26 rasteve të shqyrtuara nga ekspertët e Qendrës “Fol”, ndërsa në 3 raste të tjera Prokuroritë e Rretheve i janë drejtuar SPAK për kompetencë. Në 2 raste ka qenë Prokuroria e Tiranës që ka regjistruar procedimin penal. Rastet e mos fillimit janë 5.

Një shpërndarje e 59 rasteve të monitoruara të korrupsionit sipas neneve

Duke analizuar 59 rastet e korrupsionit nga projekti 2020-2021 të pranishme në këtë raport 3 mujor vihet re “Shpërdorimi i detyrës”, i cili përbën mos përmbushje të rregullt të detyrës, në përputhje me parashikimin e nenit 248 K.P përbën një ndër degëzimet kryesore në kategorinë e veprave penale në fushën e korrupsionit. Vepra e dytë më e hetuar nga rastet e korrupsionit rezulton të jetë “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” në 12 raste, të gjitha raste të hetuara nga SPAK. Rastet që lidhen me korrupsionin aktiv dhe pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të lartë të drejtësisë përbëjnë 6 raste të tjera, nga 3 për secilën vepër. Janë dhe 4 raste në të cilat ka konsumim të më shumë se një veprë, përkatësisht të nenit 135 - Vjedhje e kryer duke shpërdoruar detyrën dhe nenit 248 - Shpërdorim detyre. Një paraqitje e 59 rasteve të korrupsionit trajtuar nga projekti i kaluar ku evidentohen numri i rasteve në shkallët e gjykimit. Vihet re se ekziston një përputhshmëri e konsiderueshme lidhur me masat e sigurimit të dhëna nga 2 shkallët e gjykimit.






GRAFIKU ARREST NË BURG KËRKUAR NGA PROKURORIA DHE NGA GJSH1 DHE APELI

59 rastet e korrupsionit të trajtuara nga ekspertët e Qendrës “Fol” janë kategorizuar bazuar në tipologjinë e punës që realizojnë personat për të cilët është realizuar kallëzimi penal dhe referuar vetë figurës së veprës penale. Megjithatë shumica janë individë gjithsesi ka një element shqetësues lidhur me rastet që kanë të bëjnë me institucione publike si IKMT, Ministri të linjës dhe Drejtori brenda tyre, TIA, Pronat dhe Kadastra të cilat të grupuara janë rreth 17% të totalit vetëm në këtë segment të shqyrtimit të rasteve.



Nenet ku subjekt referues është SPAK



Nisur nga 59 rastet e monitoruara nga ana e ekspertëve, rezultojnë se subjektet referues të ngjarjeve të kategorizuara nën fushë-veprimin e korrupsionit janë SPAK, Shtetasit, Policia, Policia Ushtarake, Prokuroria e Përgjithshme dhe Avokatët. Nga përqindjet dallohet që SPAK mbart një peshë të rëndësishme si organ i akuzës në referimin e shumë prej çështjeve në të cilat subjekt është korrupsioni.

SUBJEKTE REFERUESE

■ Avokat ■ Policia ■ Policia Ushtarake ■ Prokuroria e Përgjithshme ■ Shtetasi ■ SPAK

